



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2011
Nr.ref.:RK131/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 12/11

Parashtrues

Amrush Rexhepi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. Nr. 256/08 të 15 nëntorit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtar
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Amrush Rexhepi nga fshati Zabel i Epërm, komuna e Gllgocit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar është aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 256/08 i 15 nëntorit 2010, me të cilin refuzohet revizioni ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. Br. 512/2006 të datës 25 shkurt 2008.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. Nr. 256/08 të 15 nëntorit 2010 duke mos përmendur nenet konkrete të Kushtetutës, por thekson se e drejta në pronë është e garantuar me kushtetutën e Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare gjithkund në botë dhe se me vendimet e gjykatave atij i është bërë padrejtësi.

Baza juridike

4. Neni 113.7 dhe 21.4 i Kushtetutës, neni 20, neni 22.7 dhe neni 22.8 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 16 dhjetorit 2008. (në tekstin e mëtejme: "Ligji") dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Rregullorja e Punës").

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Gjykata") më 2 shkurt 2011.
6. Më 23 mars 2011 Gjykata Kushtetuese e njoftoi z. Amrush Rexhepin, Gjykatën Supreme të Kosovës, Gjykatën e Qarkut në Prishtinë si dhe Gjykatën Komunale të Glllogocit se është iniciuar procedura e vlerësimit të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese.
7. Me vendimin e Kryetarit (Nr.GJR. 12/11 të 2 mars 2010), gjyqtari Ivan Čukalović u emërua gjyqtar raportues.
8. Po të njëjtën ditë, me vendimin kryetari Nr. KSH. 12/11 Kryetari e emëroi kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Prof. Dr. Gjyljeta Mushkolaj dhe Prof. Dr. Iliriana Islami.
9. Më 31 mars 2011 Gjykata Supreme e Kosovës në përgjigjen e saj dërguar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës ka theksuar se nuk asgjë të re për të shtuar dhe se mendimi i tyre për objektin e çështjes është dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Më 8 prill 2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë në përgjigjen e saj i dërgoi Gjykatës Kushtetuese si dokumentacion shtesë fotokopjet e 3 aktgjykimeve që i kanë nxjerrë gjykatat e lartpërmendura.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 8 maj 1987 me aktvendimin e Komisionit për Komasaçion të Kuvendit Komunal të Glllogocit 01. nr. 461-29 është kryer komasaçioni në komunën kadastrale „Zabel i Epërm“.

12. Parashtruesi i kërkesës kishte hyrë në procesin e komasacionit me tokën në sipërfaqe prej 2.39.35 ha e cila nga ana e komisionit për komasacion ishte vlerësuar me 13.900.89 pikë.
13. Duke marrë parasysh faktin se për të gjithë pjesëmarrësit në komasacion ka vlejtur zvogëlimi prej 0.025 (me qëllim të sigurimit të rrugëve dhe kanaleve të ujësjellësit). Parashtruesit të kërkesës iu nda toka në tabelën kadastrale 427 , ngastra 35 me kulturë arë e klasit III dhe IV në sipërfaqe prej 0.75.20 ha si dhe tabelën kadastrale 427 ngastra 42 me kulturë arë e klasit IV, V dhe VI në sipërfaqe prej 1.12.26 ha, që është gjithsej tokë në sipërfaqe prej 1.87.46 ha që shndërruar në pikë i kishte 13.623.08.
14. Nga kjo gjendje faktike shihet se sipërfaqja që i është ndarë parashtruesit të kërkesës është më e vogël se sipërfaqja me të cilën parashtruesi i kërkesës kishte hyrë në procesin e komasacionit, për shkak se vlera e tokës me të cilën ai kishte hyrë në procesin e komasacionit është më e ulët se vlera e tokës të cilën e kishte marrë në procesin e komasacionit, ndërsa vlera e pikëve është afërsisht e njëjtë me vlerën e pikëve me të cilat kishte hyrë në procesin e komasacionit.
15. Në pikën II të dispozitivit të aktvendimit të Komisionit për Komasacion të Kuvendit Komunal të Glllogocit 01. Nr. 461-29 të 8 majit 1987 konstatohet se pranimi dorëzimi i tokës është kryer me raportin nr. 461-29 të 17 nëntorit 1986 dhe se në bazë të plotfuqisë së tij pranimi dhe dorëzimi i tokës konsiderohet i përhershëm.
16. Ndaj këtij aktvendimi parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ankesë pranë Drejtoriatit Krahinor për Marrëdhënie Pronësore – Juridike.
17. Parashtruesi i kërkesës pretendon se aktvendimi i Komisionit për Komasacion të Kuvendit Komunal të Glllogocit 01. Nr. 461-29 të 8 majit 1987 nuk është zbatuar në tërësi në terren dhe se ai shfrytëzon vetëm 1.54.95 ha.
18. Për shkak të kësaj gjendjeje faktike si dhe me kërkesë të parashtruesit me qëllim që të konstatohet gjendja e saktë faktike gjykata nxjerr vendim që të bëhet shikimi në vendin e ngjarjes.
19. Në të vërtetë, me shikimin në vendin e ngjarjes të kryer më 11 gusht 2004 dhe në bazë të mendimit dhe konkludimit me shkrim të ekspertit të gjeodezisë Xhafer Ramës të 18 korrikut 2005, me ndryshimet dhe sqarimet e bëra më 18 tetor 2005, kishte ardhur deri te konkludimet vijuese:
 - a) Që Amrush Rexhepi kishte hyrë në posedim dhe e shfrytëzonte tokën që i ishte ndarë në bazë të vendimit të komasacionit në tabelën kadastrale 427 ngastra 35 në sipërfaqe 0.78.28 ha.
 - b) Që Amrush Rexhepi nuk kishte hyrë dhe nuk e shfrytëzon tokën që i ishte ndarë në bazë të vendimit të komasacionit në tabelën kadastrale 427 ngastra 42, që kjo ngastër është në posedim të Nexhat Avdullahut në sipërfaqe prej 0.12.19 ha, Banush Avdullahut në sipërfaqe 0.28.13 ha, Shefqet Avdullahut në sipërfaqe 0.60.95 ha dhe Sami Avdullahut në sipërfaqe 0.08.50 ha. Sipas mendimit të ekspertit ata mbajnë në posedim këto ngastra pa bazë ligjore.
 - c) Eksperti ka konstatuar se Amrush Rexhepi ka marrë në posedim dhe e shfrytëzon tokën në tabelën kadastrale 425 ngastra 30 në sipërfaqe 0.58.97 ha , tabelën kadastrale 424 ngastra 31/1 në sipërfaqe 0.29.70 ha , në tabelën kadastrale 423 ngastra 15 në sipërfaqe 0.75.10 ha , dhe se azhurnimi nuk është kryer në

- përputhje me aktvendimin e Komisionit për Komasaçion të Kuvendit Komunal të Drenasit.
- d) Në fund mendimi i ekspertit të gjeodezisë është se sipërfaqja e cila në bazë skicave i është ndarë Amrush Rexhepi më e vogël për 0.20.51 ha se ajo që tani e shfrytëzon, mirëpo sipërfaqja që i është ndarë në aktvendim në krahasim me sipërfaqen me të cilën kishte hyrë në komasaçion është e njëjtë sa i përket vlerës në pikë.
20. Në bazë të mendimit të tillë të ekspertit, Amrush Rexhepi parashtrroi kërkesë padi me të cilën kërkoi nga Komuna e Glllogocit që t'ia kompensojë fitimin e humbur për shkak të pamundësisë për të shfrytëzuar tokën në sipërfaqe prej 0.20.51 ha për mbjelljen e të korrave në periudhën 2001, 2002, 2003, 2004, 2005 dhe 2006 në shumën 1,133.34 euro me normën e interesit prej 3.5% nga viti 2001.
21. Gjykata Komunale e Glllogocit me aktgjykimin C. Nr. 09/04 në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 9 mars 2006 e refuzoi si të pabazë kërkesë padinë e z. Amrush Rexhepit me të cilën kishte kërkuar që Komuna e Glllogocit t'ia kompensojë fitimin e humbur për shkak të pamundësisë për të shfrytëzuar tokën në sipërfaqe prej 0.20.51 ha.
22. Në arsyetimin e aktgjykimit Gjykata Komunale e Glllogocit kishte thënë se e kishte miratuar në tërësi mendimin e ekspertit të gjeodezisë i cili ishte në pajtim me provat tjera materiale në shkresat e lëndës, duke theksuar se me aktvendimin e Komisionit për Komasaçion të Kuvendit Komunal të Glllogocit 01. Nr. 461-29 të 8 majit 1987 z. Amrush Rexhepi i është ndarë toka në tabelën kadastrale 427 ngastra 35 dhe 42 dhe se Amrush Rexhepi **ka qenë i obliguar të insistojë që t'i vihen në posedim dhe shfrytëzim ngastrat të cilat ia kishte ndarë me aktvendim Komisioni për Komasaçion dhe jo të hyjë në posedim të ngastrave tjera.**
23. Gjykata Komunale e Glllogocit kishte ardhur në përfundim se në rastin konkret Komuna e Glllogocit në asnjë mënyrë nuk i kishte shkaktuar dëm z. Amrush Rexhepi, siç kishte pohuar ai në kërkesë padinë prandaj edhe i ishte refuzuar kërkesa si e pabazuar.
24. I pakënaqur me një aktgjykim të tillë z. Amrush Rexhepi ushtron ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
25. Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktgjykimin Ac. nr. 512/2006 të 25 shkurtit 2008 e refuzon ankesën si të pabazuar dhe e vërteton aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Glllogocit C. Nr. 09/04 të 9 marsit 2006.
26. Ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 512/2006 të 25 shkurtit 2008 z. Amrush Rexhepi parashtron revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.
27. Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Rev. nr. 256/2008 të 15 nëntorit 2010 e refuzon si të pabazuar revizionin e parashtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac. nr. 512/2006 të 25 shkurtit 2008.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimet e organeve gjyqësore të Kosovës me të cilat **ishte refuzuar si e pabazuar** kërkesë padia e Amrush Rexhepit, me të cilën ai kishte kërkuar nga Komuna e Glllogocit që t'ia kompensojë fitimin e humbur për shkak të pamundësisë për të shfrytëzuar tokën në sipërfaqe prej 0.20.51 ha për mbjelljen e të korrave në periudhën 2001, 2002, 2003, 2004, 2005

dhe 2006, atij i është bërë padrejtësi edhe pse ai nuk përmend nenet konkrete të Kushtetutës.

29. Prandaj parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese që ta korrigjojë këtë padrejtësi në mënyrë që Komuna e Glllogocit t'ia kompensojë këtë humbje dhe t'ia japë një tokë tjetër që ka mbetur e lirë pas kryerjes së komasacionit.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë

30. Për të qenë kërkesa e pranueshme, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse Parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës të Gjykatës Kushtetuese.
31. Kërkesa e parashtruesit është dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese më 7 shkurt 2011, ndërsa vendimi i fundit në lidhje me këtë rast është nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës më 15 nëntor 2010. Rrjedhimisht Gjykata konstaton se kërkesa është parashtruar në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
32. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta (shih Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin KI 13/09 Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010).
33. Në rastin e paraqitur, parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë provë *prima facie* se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me kushtetutë në kreun II, (Të drejtat dhe liritë themelore nenet 21-56 të Kushtetutës) dhe se Gjykata Supreme ka marrë vendim në mënyrë arbitrare kur e ka refuzuar kërkesën e parashtruesit si të pabazuar (shih, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99 të 31 majit 2005).
34. Në këtë rast duke marrë parasysh se gjykatat e rregullta kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës ka marrë kompensim për pronën e shpronësuar, madje për nga vlera me numër më të madh të pikëve, me kusht që të insistonte në shfrytëzimin e atyre ngastrave që i janë ndarë nga ana e Komisionit për Komasacion dhe jo ngastrave tjera, Gjykata Kushtetuese konsideron se nga veprimet e autoriteteve publike parashtruesit të kërkesës nuk i është shkelur asnjë e drejtë e garantuar me Kushtetutë.
35. Nga kjo rezulton që kërkesa është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (2b) të Rregullores së Punës i cili parashikon që „ Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se: b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejtë kushtetuese”.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) dhe 36 (2b) të Rregullores së Punës, në seancën e mbajtur më 7 korrik 2011, njëzëri

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

